



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:84/25, Datë: 31/01.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ. Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr.01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 133-të, mbajtur më datë 17.01.2025, mori:

## V E N D I M

**I. Nuk akreditohet** Kolegji Britanik i Teknologjisë në nivel institucional.

**II.** Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## A R S Y E T I M I

Kolegji Britanik i Teknologjisë ka parashtruar kërkesë me Nr.prot.1494/24, datë 31.07.2024, në Agjencisë së Kosovës për Akreditim (në tekstin e mëtejme AKA) për akreditim në nivel institucional.

AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjit Britanik i Teknologjisë me qëllim të vlerësimit në nivel institucional. Vizita është organizuar me datë 20.11.2024, me ekipin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit me përbërje: Milan Pol, Olgun Cicek dhe Domagoj Švigir.

Bazuar në Rregulloren (AKA) Nr.03/2024 për Përzgjedhjen, Angazhimin dhe Kompensimin e Ekspertëve të Jashtëm, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertëve ndërkombëtar) ka hartuar raportin e vlerësimit dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka konstatuar se nga njëmbëdhjetë (11) fushat e standardeve të akreditimit, Kolegji Britanik i Teknologjisë është vlerësuar se përmbushë:

- Plotësisht një (1) standard akreditimi;
- Substancialisht tetë (8) standarde të akreditimit;
- Pjesërisht një (1) standard të akreditimit;
- Kurse një (1) standard akreditimi nuk është në përputhje me kërkesat (standardi 10, i detyrueshëm).

Njëkohësisht, Ekipi i Ekspertëve formuloi 16 rekomandime të cilat sipas mendimit të Ekipit të Ekspertëve mund të ndihmojnë në përmirësimin e mëtejshëm të institucionit, nëse merren parasysh.

Në përgjithësi, Ekipi i Ekspertëve konsideron se Kolegji Britanik i Teknologjisë nuk është në përputhje me standardet e përfshira në Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 të Manualit të Akreditimit dhe, për rrjedhojë, **nuk rekomandon akreditimin e institucionit.**

Këshilli Shtetëror i Cilësisë në mbledhjen e 133 të mbajtur më 17.01.2025 ka shqyrtuar kërkesën e Kolegjit Britanik i Teknologjisë dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës si dhe në rekomandimin përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

*Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtoj ankesë sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatit prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së.*

Prof. Asoc. Dr. Blasiya Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi ju dërgohet :

- Kolegjit Britanik i Teknologjisë
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.